



Informacione Bazë Për Kërkuesit E Mbrojtjes Ndërkombëtare Në Greqi

Kërkues i mbrojtjes ndërkombëtare është nështetasi i një shteti të tretë ose i pa shtetësi, i cili depoziton kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare pranë Zyrate Rajonale të Azilit ose Njësive të Pavarura të Azilit ose Njësive të Shërbimit të Azilit që ndodhen pranë Qendrave të Pritjes e Identifikimit. Kërkuesi i mbrojtjes ndërkombëtare kërkon të mos dëbohet sepse ka frikë përndjekjeje për shkak të racës, fesë, kombësisë, pjesmarrjes në grupe të veçanta shoqërore ose bindjeve politike, ose sepse rrezikon të pësojë dëmtim të rëndë në vendin e origjinës ose të vendqëndrimit të tij të mëparshëm, veçanërisht sepse rrezikohet me dënim me vdekje ose ekzekutim, me tortura apo trajtim çnjerëzor e poshtërues, ose rrezikohet jeta ose integriteti i tij për arsye të konflikteve ndërkombëtare ose luftës civile.

Kërkues për mbrojtje ndërkombëtare konsiderohet edhe i huaji, që hyn në Greqi sipas Rregullores së «Dublin-it»¹

Kërkesa e mbrojtjes ndërkombëtare: Ku dhe si do ta depozitoni

- Kërkesa depozitohet pranë Autoriteteve të Pranimit të cilët kryejnë menjëherë regjistrimin e plotë. Autoritetet kompetente të Pranimit janë Zyrat Rajonale të Azilit, Njësiti e Pavarura të Shërbimit dhe Njësiti Mobile të Shërbimit të Azilit

- Nëse keni hyrë në vend pa kryer procedurat ligjore ose qëndroni në Greqi pa përmbushur formalitetet e nevojshme ligjore, do të transferoheni në Qendër Pritjeje dhe Identifikimi, dhe nga momenti që nuk keni ndonjë dokument autoriteti publik që të vërtetojë nënshtetësinë dhe identitetin tuaj, do t'u nënshtroheni procedurave të pritjes dhe identifikimit. Në këtë rast, për të depozituar kërkesë mbrojtjeje ndërkombëtare do t'u referoheni zyrate kompetente vendore të Shërbimit Rajonal të Azilit, Njësi e të cilit mund të funksionojë në Qendrën e Pritjes e Identifikimit ku qëndroni. Do të qëndroni detyrimisht në ambjentet e Qendrës për sa kohë zgjat procedura e shqyrtimit të kërkesës suaj, përderisa kjo periudhë nuk i tejkalon njëzet e pesë (25) ditët

- Kërkesa e Mbrojtjes Ndërkombëtare depozitohet personalisht. Ndërkohë, kërkesa mundet që të depozitohet në mënyre elektronike nëpërmjet aplikacionit të vetëregjistrimit elektronik.

- Mund të depozitoni kërkesë dhe për anëtarët e familjes suaj nëse këta të fundit janë me ju në Greqi dhe e dëshirojnë këtë gjë. Do të duhet që edhe ata të paraqiten bashkë me ju në Shërbimin e Azilit.

- Kur të depozitoni kërkesën tuaj do të duhet t'u përgjigjeni me sinqeritet të plotë pyetjeve të nëpunësit. Nëse dorëzoni të dhëna ose dëshmi të rreme, kjo do të ndikojë negativisht në gjykimin e çështjes suaj.

- Nëse jeni i mitur i pashoqëruar, domethënë jeni nën moshën 18 vjeç dhe nuk shoqëroheni nga ndonjë i rritur përgjegjës për kujdesin tuaj, në bazë të legjislacionit ose

¹ Shtetet që zbatojnë Rregulloren "Dublin III " janë: Austria, Belgjika, Bullgaria, Franca, Gjermania, Danimarka, Zvicra, Estonia, Mbretëria e Bashkuar, Irlanda, Islanda, Spanja, Italia, Qipro, Letonia, Lituania Lihtenshtajn, Luksemburgu, Malta, Norvegjia, Holanda, Hungaria, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Suedia, Çekia, Finlanda.



praktikës greke, Autoritetet duhet të informojnë menjëherë Prokurorin kompetent. Prokurori do t'ju caktojë një Kujdestar i cili do të ketë përgjegjësinë për ju dhe do të mbrojë interesat tuaja. Nëse jeni nën 15 vjeç kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare duhet ta depozitoni Kujdestari që ju është caktuar. Nëse jeni mbi 15 vjeç mund të depozitoni vetë kërkesën tuaj. Autoritetet do të kujdesen për mbrojtjen dhe akomodimin tuaj në një ambient të përshtatshëm për të mitur.

- Kur të depozitoni kërkesën për mbrojtjen ndërkombëtare, do të fotografoheni dhe do t'ju merren shënjat e gishtave, ju sikurse dhe antarëve të familjes suaj që janë mbi 14 vjeç. Shenjat e gishtave do të futen në Bazën Qendrore Europiane të EURODAC dhe, nëse ju keni depozituar kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në vend tjetër European i cili zbaton Rregulloren e "Dublin III", do të transferoheni atje që të shqyrtohet kërkesa juaj.

- Do të duhet të dorëzoni dokumentet tuaja të udhëtimit (pasaportë) ose çfarëdo dokumenti tjetër që keni në zotërim dhe që ka lidhje me shqyrtimin e kërkesës suaj dhe me vërtetimin e identitetit tuaj dhe të antarëve të familjes suaj, të shtetit nga keni ardhur dhe të vendit tuaj të origjinës, si edhe të gjendjes suaj familjare.

- Mund t'ju kryhet kontroll trupor ose kontroll i sendeve tuaja. Mund t'u nënshtroheni analizave mjekësore.

- Shërbimi i Azilit do t'ju caktojë një datë për intervistë dhe do të merrni kartën e kërkuarit të mbrojtjes ndërkombëtare që mund të jetë e vlefshme deri për gjashtë muaj. Këtë kartë duhet ta keni gjithmonë me vete.

-nuk duhet të plastifikohet

-duhet të mbahet në gjendje të mire

-nuk duhet ta humbni, sepse zëvendësohet me shumë vështirësi.

- Kur depozitoni kërkesën, autoritetet kompetente janë të detyruara t'ju informojnë në gjuhën që kuptoni për procedurën, të drejtat dhe detyrimet tuaja si kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, si edhe për afatet që janë në fuqi gjatë procedurës.

- Nëse jeni viktimë torturash, përdhunimi ose aktesh të tjera të rënda dhune, duhet të informoni për këtë Autoritetet, me qëllim që t'ju ndihmojnë.

- Mund të kërkontë të komunikoni me Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, ose me organizatë që siguron ndihmë juridike, mjekësore dhe psikologjike.

- Gjatë procedurës keni të drejtë të kërkontë ndihmën e një avokati ose këshilltari tjetër të pëlqimit tuaj (pa ndërmjetësimin e Shërbimit të Azilit). Pagesa dhe shpenzimet e një avokati apo këshilltari tjetër do të rëndojnë mbi ju.

- Nëse dëshironi, mund t'ju jepet një periudhë e shkurtër kohe për t'u përgatitur si duhet për intervistën dhe të konsultoheni me avokat ose këshilltar që t'ju ndihmojë gjatë procedurës.

- Në çdo rast, ju mund të kërkontë që intervista dhe përkthimi të kryhen nga nëpunës i gjinisë që ju dëshironi, nëse ekzistojnë arsye serioze për këtë. Kërkesa në fjalë do të shqyrtohet nga Shërbimi dhe do të plotësohet nëse ekziston kjo mundësi.

- Në rast se jeni i mitur i pashoqëruar, duhet të informoheni nga përfaqësuesi (kujdestari) juaj për intervistën. Përfaqësuesi (kujdestari) juaj do të jetë i ftuar dhe mund t'ju shoqërojë në intervistë. Autoritetet mund t'ju bëjnë analiza mjekësore për të përcaktuar moshën tuaj. Për këtë procedurë duhet të informoheni ju dhe përfaqësuesi juaj dhe duhet të bini dakord ju ose përfaqësuesi juaj.



Dorëheqja dhe revokimi i heshtur i kërkesës së mbrojtjes ndërkombëtare

Ju keni mundësi kurdo që të dëshironi, të hiqni dorë nga kërkesa juaj. Duhet të paraqiteni personalisht pranë Zyrës Rajonale të Azilit ku e depozituat dhe të jepni dorëheqjen me shkrim. Në rast se ju jepni dorëheqje kërkesa juaj nuk do të shqyrtohet dhe do të duhet të largoheni nga vendi, përderisa nuk jeni zotërues i ndonjë statusi tjetër qëndrimi.

- Shërbimi i Azilit mund të konsiderojë se nuk ju intereson vazhdimi i shqyrtimit të kërkesës suaj (revokim i heshtur) në rastet e mëposhtme:

a) nëse refuzoni të jepni informacione me rëndësi të madhe për çështjen tuaj të cilat ju janë kërkuar nga Autoritetet,

b) nëse nuk paraqiteni në intervistën tuaj personale që ju ishte përcaktuar nga Shërbimi,

c) nëse arratiseni nga vendi i mbajtjes në arrest,

d) nëse nuk zbatoni detyrimet që ju janë imponuar nga policia në vend të mbajtjes në arrest,

e) nëse largoheni nga vendbanimi që ju është përcaktuar nga autoritetet pa i informuar ato,

f) nëse largoheni nga vendi pa kërkuar leje nga Shërbimi i Azilit,

g) nëse nuk e informoni menjëherë Shërbimin e Azilit për ndryshim të adresës suaj dhe të të dhënave të kontaktit me ju,

h) nëse nuk kontaktoni me Shërbimin e Azilit në rastin kur kjo gjë ju kërkohet ,

i) nëse nuk depozitoni dokumente të cilat është vërtetuar se zotëroni ose keni detyrimin që t'i keni në zotërimin tuaj dhe mundeni t'i depozitoni,

j) nëse nuk paraqiteni për të rinovuar kartën tuaj e shumta një ditë pune më vonë nga afati i skadimit të saj.

k) nëse nuk bashkëpunoni me autoritetet duke shkelur detyrimin e bashkpunimit,

l) nëse nuk i bindeni vendimit të transferimit tuaj në menyrë që të përfundojë procedura e pritjes dhe identifikimit, duke penguar për shkak të këtij refuzimi, përmbushjen pa ndërprerje të procedurave të shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare.

Në rast se Autoritetet Vendimarrëse konsiderojnë se keni tërhequr në heshtje kërkesën tuaj, do të shqyrtojnë këtë kërkesë në bazë të të dhënave në dispozicion dhe në rast se konsiderojnë se është e pabazuar, do ta refuzojnë. Nëse Shërbimi refuzon kërkesën tuaj, keni të drejtë të ushtroni apelim në Autoritetin e Apelit.

Nëse Shërbimi konsideron se nuk ka në dispozicion të dhëna të mjaftueshme që të shqyrtojë kërkesën tuaj, do të marrë vendim ndërprerjeje të kërkesës suaj. Nëse merret vendim ndërprerjeje ndaj kërkesës suaj, zbatohet procedura e kthimit në vendin tuaj. Keni të drejtë vetëm një herë dhe brenda afatit nëntë (9) mujor nga dalja e vendimit të ndërprerjes, të kërkonti vazhdimin e procedurës së shqyrtimit të çështjes suaj ose të depozitoni kërkesë të re.

Procedura e shqyrtimit të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare

- Aksesimi në procedurën e mbrojtjes ndërkombëtare është i lirë dhe falas. Çdo nënshtetas vendi të tretë ose i pashtetësi ka të drejtë depozitimi të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare

- Regjistrimi i plotë i kërkesës suaj përmban të dhënat e identifikimit, shtetin e prejardhjes suaj, emrin e babait, të nënës, të bashkëshortit/-es dhe të fëmijëve, adresën e postës elektronike nëse ekziston, parametra biometrikë identifikimi, raport të plotë të arsyeve



për të cilat kërkoni mbrojtje ndërkombëtare, adresë banimi ose qëndrimi, gjuhën në të cilën dëshironi të shqyrtohet kërkesa juaj si edhe, përcaktimin e një përfaqësuesi të autorizuar, nëse dëshironi.

- Në rast se për çfarëdo arsye nuk është i mundur regjistrimi juaj i plotë, do të duhet, në hapësirën e tre (3) diteve pune nga depozitimi i kërkesës suaj, të bëhet regjistrimi i thjeshtë të paktën i të dhënave të nevojshme ndër të cilat edhe gjuha në të cilën dëshironi të shqyrtohet çështja juaj. Në vijim do të kryhet regjistrimi i plotë i kërkesës suaj në një datë të përcaktuar për të cilën do të njoftoheni. Në këtë rast do t'ju jepet dokument që përmban të dhënat tuaja dhe fotografinë tuaj. Këtë dokument do ta dorëzoni në regjistrimin tuaj përfundimtar dhe do të zëvendësohet me Kartën e Kërkuesit të Mbrojtjes Ndërkombëtare.

- Kur depozitoni kërkesën, do të ketë përkthyes që do t'ju ndihmojë në gjuhë që kuptoni në mënyrë që të ndihmojë në komunikimin tuaj nëpunësit e Shërbimit të Azilit

- Do të duhet të dorëzoni dokumentet tuaja të udhëtimit (pasaportë) ose çfarëdo dokumenti tjetër që keni në disponimin që ka lidhje me shqyrtimin e kërkesës suaj dhe me vërtetimin e identitetit tuaj dhe të anëtarëve të familjes suaj, të shtetit nga erdhët dhe të vendit të origjinës, si dhe të gjendjes suaj familjare.

- Ditën që ju ka caktuar Shërbimi i Azilit, do të jepni intervistë para nëpunësit të Shërbimit të Azilit. Do të duhet t'u përgjigjeni me sinqeritet të plotë pyetjeve të tij, të depononi vetëm fakte të vërteta në mënyrë të plotë dhe të mos fshihni asnjë të dhënë që ka lidhje me kërkesën tuaj. Nëse do të paraqesni dëshmi ose fakte/raste të pavërteta do të ndikoni negativisht në gjykimin mbi kërkesën tuaj.

- Nëpunësi i Shërbimit të Azilit do t'ju pyesë gjatë intervistës veçanërisht për të dhënat që ju përmendni në aplikimin tuaj, për të dhënat e identitetit tuaj, për mënyrën se si keni ardhur në Greqi, për arsyet që u larguat nga shteti juaj i origjinës ose shteti ku qëndronit, nëse jeni pa shtetësi, si dhe për arsyet për të cilat nuk mundeni ose nuk dëshironi të ktheheni në të. Gjatë intervistës mund të shtoni dhe çfarëdo të dhëna të tjera që i konsideroni të nevojshme.

- Nëse, për shkak të gjuhës, ju nuk mund të komunikoni me nëpunësin e Shërbimit të Azilit, në intervistë do të jetë i pranishëm edhe përkthyesi.

- Në intervistë ju mund të shkoni bashkë me avokat ose këshilltar tjetër (ligjor, mjekësor, mjek, psikolog ose punonjës social)

- Ato që do të thoni në intervistë janë në besueshmëri/konfidencë.

- Intervista juaj mund të inçizohet. Nëse intervista nuk inçizohet, nëpunësi do të përpilojë një tekst (procesverbal) që do të përfshijë të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e intervistës. Në këtë rast ju duhet të kontrolloni tekstin e procesverbalit me ndihmën e përkthyesit, të konfirmoni përmbajtjen e tij ose të kërkoni të bëhen korrigjime dhe ta nënshkruani atë. Mund të merrni kur të dëshironi kopje të procesverbalit apo të raportit të hartuar dhe të inçizimit të intervistës suaj.

- Pas intervistës Shërbimi i Azilit do të vendosi dhënien e statusit të refugjatit ose të përfituesit të mbrojtjes të plotësuese ose do të refuzojë çështjen tuaj.

- Nëse jeni i mitur i pashoqëruar, do të duhet të informoheni nga kujdestari juaj për intervistën. Kujdestari juaj do të ftohet dhe mund të jetë bashkë me ju në intervistë. Nëse lindin dyshime përsa i përket moshës suaj, Autoritetet mund t'ju bëjnë analiza mjeksore që të



HELLENIC REPUBLIC

Ministry of Migration & Asylum

përcaktojnë moshën tuaj. Për këtë procedurë duhet të informoheni ju dhe kujdestari juaj dhe duhet të bini dakord ju ose kujdestari juaj.

- Me daljen e vendimit të kërkesës suaj, Shërbimi i Azilit do t'ju njoftojë që ta merrni në dorëzim. Do të njoftoheni në bazë të të dhënave të kontaktit që keni deklaruar ose me telefonatë, ose me letër apo telegram, ose faks, ose e-mail.

- Shërbimi të Azilit duhet t'ju dorëzojë vendimin me ndihmën e një përkthyesi në gjuhën që ju kuptoni

Të Drejtat dhe Detyrimet e Kërkuesve të Mbrojtjes Ndërkombëtare

Të drejtat e kërkuesve të mbrojtjes ndërkombëtare

Si kërkues i mbrojtjes ndërkombëtare keni të drejtat në vazhdim:

- Keni të drejtë të qëndroni në Greqi deri sa të përfundojë shqyrtimi i kërkesës suaj dhe ndalohet të dëboheni deri sa të përfundojë shqyrtimi i çështjes suaj.

- Mund të qarkulloni lirshëm brenda vendit, përveç rastit kur në kartën që keni marrë përcaktohet një pjesë e caktuar e vendit në të cilën lejohet të qarkulloni, domethënë kufizim lëvizjeje (gjeografik).

- Përderisa nuk punoni dhe të ardhurat tuaja ekonomike nuk mjaftojë për mbulimin e nevojave të përditshme, keni të drejtën e ndihmave. Gjithashtu, mund të kërkoni të strehoheni në Qendra Strehimi ose në tjetër vend strehimi (programe strehimi në shtëpi private ose hotele). Kërkesa juaj do të pranohet në rast se ekzistojnë vende të lira.

- Keni të drejtë të punësoheni në bazë të kushteve që përcakton legjislacioni grek, pasi të kenë kaluar gjashtë (6) muaj nga data e depozitimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, dhe nëse keni Kartën e Kërkuesit të Mbrojtjes Ndërkombëtare.

- Keni të njëjtat të drejta dhe detyrime sigurimi, si i punësuar, si edhe qytetarët grekë.

- Në mënyrë që të keni akses në ndihmën e shërbimit mjekësor, farmaceutik dhe spitalor, mund të merrni Numrin e Përkohshëm të Sigurimit dhe Kujdesit Shëndetsor për të Huaj (P.A.A.Y.P.A.)

- Fëmijët tuaj kanë akses në shërbimin arsimor falas.

- Nëse jeni i rritur keni të drejtën e aksesit në arsimin e mesëm.

- Keni akses në trajnimin profesional.

- Nëse jeni person me shkallë invaliditeti 67% e lart, keni të drejtën të merrni ndihmë invaliditeti, në rast se nuk është i mundur qëndrimi juaj në një Qendër Strehimi.

Detyrimet e kërkuesve të mbrojtjes ndërkombëtare

Si kërkues i mbrojtjes ndërkombëtare në Greqi, keni detyrimet në vijim:

- Nuk mund të udhëtoni jashtë Greqisë me përjashtim të kushteve specifike kur shfaqen arsye serioze humanitare, të cilat diktojnë paraqitjen tuaj në shtet tjetër si për shembull arsye serioze shëndeti. Do të duhet të bëni kërkesë pranë Shërbimit në mënyrë që të lëshohet



dokument udhëtimi. Nëse largoheni nga vendi pa e informuar Shërbimin e Azilit, shqyrtimi i kërkesës suaj do të ndërpritet.

- Duhet të qëndroni në Greqi deri sa të përfundojë shqyrtimi i kërkesës suaj.
- Nuk mund të sillni në Greqi familjen tuaj nga vendi juaj i origjinës.
- Duhet të bashkëpunoni me organet greke për çdo çështje që ka të bëjë me kërkesën tuaj dhe me verifikimin e të dhënave të identitetit tuaj.
- Duhet të paraqitëni përpara Autoriteteve të Pranimi personalisht, pa vonesë, sa herë që thirrëni nga autoritetet përkatëse.
- Do të duhet të dorëzoni dokumentin tuaj të udhëtimit dhe të depozitoni çfarëdolloj dokumenti tjetër që keni në disponimin tuaj dhe që ka lidhje me shqyrtimin e kërkesës dhe me të dhënat që vërtetojnë identitetin tuaj, shtetin nga erdhët dhe vendin e origjinës, si dhe gjendjen tuaj familjare
- Duhet të informoni menjëherë Shërbimin e Azilit për adresën tuaj të banimit dhe të dhënat tuaja të komunikimit, si dhe për çdo ndryshim të tyre (Aneks: Linku 6). Mund të depozitoni edhe kërkesë elektronike për ndryshim të të dhënave të komunikimit (linku i kërkesave elektronike). Shërbimi i Azilit do të dërgojë në adresën që deklaroni dokumenta që kanë lidhje me kërkesën tuaj.
- Duhet të respektoni afatet që ju caktohen në stade të ndryshme të procedurës së shqyrtimit të kërkesës tuaj.
- Duhet të kujdeseni për rinovimin e kartës suaj në kohë, para se të skadojë, dhe e shumta një ditë pune pas datës së skadencës së saj.
- Duhet të bëni të ditur gjëndjen tuaj ekonomike në rast se merrni ndihma nga Shteti.
- Ju hiqet e drejta e strehimit falas në qendrat e pritjes e strehimit ose vende të tjera, në rast, të tilla si:
 - nëse braktisni vendet e pritjes e strehimit pa informuar autoritetet përkatëse.
 - nëse nuk deklaroni ndryshimet e të dhënave tuaja personale ose nuk u përgjigjeni kërkesave për dhënie informacionesh që lidhen me kërkesën tuaj ose nuk paraqiteni në intervistën tuaj personale brenda datës së caktuar.
 - kur pa arsye të justifikueshme nuk keni depozituar menjëherë kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare
 - nëse fshihni burime financiare dhe keni përfutur në mënyrë të padrejtë materialisht nga kushtet e pritjes.
 - nëse shkelët rregullat e funksionimit të qendrave të pritjes e strehimit.
- Shkelja e detyrimit të bashkpunimit me organet kompetente, sidomos, mos komunikimi me organet dhe mosbashkpunimi me qëllim verifikimin e të dhënave të domosdoshme për shqyrtimin e çështjes, nënkupton pengimin e përfundimit pa ndërprerje të procedurave të shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare dhe për pasojë sjell ndërprerjen e shqyrtimit të kërkesës suaj.

E drejta e apelit dhe shqyrtimi në shkallën e dytë

- Nëse kërkesa juaj refuzohet, ose ju është dhënë statusi për mbrojtje të përkohshme, (subsidiare) dhe mendoni se meritoni statusin e refugjatit, keni të drejtë të ushtroni apelim



kundrejt Organeve të Apelit. Ju duhet të dorëzoni apelimin tuaj pranë Zyrës Rajonale të Azilit ose pranë Njesisë së Zyrove Rajonale të Azilit e cila ju dorëzoi vendimin, brenda afatit që përmendet në vendimin që morët në dorëzim.

- Në rastin kur qëndroni në Qëndër larg nga Zyra Rajonale të Azilit (ose Njësia e Pavarur) që nxorri vendimin, mund të depozitoni apelimin në Zyrën Rajonale të Azilit më të afërt. Në këtë rast apelimi dërgohet brenda ditës me postë elektronike në Zyrën Rajonale të Azilit ose Njësinë e Pavarur të Shërbimit të Azilit që nxorri vendimin. Depozitimi i apelimit bëhet me paraqitjen tuaj personalisht në zyrën kompetente të Shërbimit të Azilit dhe me dorëzimin e dokumentit (apelimin) që do të nënshkruhet nga ju ose nga avokati juaj. Nëse mbaheni në arrest do të duhet të depozitoni apelimin tuaj pranë Përgjegjësit të vendit ku mbaheni në arrest ose të qëndrës, i cili do dërgojë me faks, ose me mënyrë tjetër elektronike, apelimin në Zyrën Rajonale të Azilit ose Njësinë e Pavarur të Shërbimit të Azilit e cila nxorri vendimin.

- Me depozitimin e apelimit do t'u jepet sërish Karta e Kërkuesit të Mbrojtjes Ndërkombëtare.

Apelimi juaj do të shqyrtohet nga një Komision Apeli. Komisioni i Apelit zakonisht shqyrton apelimet në bazë të të dhënave të dosjes dhe nuk ju fton për intervistë. Por, do të informoheni për datën e shqyrtimit të apelimit tuaj, si edhe se kur ju mund të dorëzoni, nëse dëshironi, materiale shtesë që t'i marrë parasysht Komisioni i Apelit.

- Në datën e shqyrtimit të apelimit tuaj jeni i detyruar të paraqiteni personalisht në zyrat qëndrore të Autoritetit të Apelit. Në rast mosparaqitjeje apelimi juaj do të refuzohet.

- Keni mundësinë, për sa kohë është në procedurë kërkesa juaj për apel, të jepni dorëheqjen prej saj. Duhet të paraqiteni personalisht pranë Zyrës Rajonale të Azilit ku e depozituat dhe të jepni dorëheqjen me shkrim. Nëse ju jepni dorëheqjen, apelimi juaj nuk do të shqyrtohet dhe do të duhet të largoheni nga vendi, përderisa nuk dispononi ndonjë status tjetër qëndrimi.

- Komisioni i Apelit mund të konsiderojë se ju nuk ju intereson të vazhdoni shqyrtimin e apelimit tuaj (revokim i heshtur) dhe të nderprese shqyrtimin e tij:

- 1) nëse refuzoni të jepni informacione me rëndësi të madhe për aplikimin tuaj të cilat ju janë kërkuar nga Autoritetet, ose
- 2) nëse arratiseni nga vendi i mbajtjes në arresti, ose
- 3) nëse nuk zbatoni detyrimet që ju janë imponuar nga Policia në vend të mbajtjes në arrest, ose
- 4) nëse largoheni nga vendi i qëndrimit që ju kanë përcaktuar autoritetet pa i informuar ato, ose
- 5) nëse largoheni nga vendi pa kërkuar leje nga Shërbimi i Azilit, ose
- 6) nëse nuk e njoftoni menjëherë Shërbimin e Azilit kur ndryshoni adresën tuaj dhe të dhënat e kontaktit, ose
- 7) nëse nuk kontaktoni me Komisionin e Apelit nëse kjo ju kërkohet, ose
- 8) nëse nuk shkoni të rinovoni kartën tuaj e shumta një ditë pune pas afatit të skadimit të saj, ose
- 9) nëse nuk depozitoni dokumenta të cilat është vërtetuar se zotëroni ose keni detyrimin që t'i keni në zotërimin tuaj dhe mund t'i depozitoni,



HELLENIC REPUBLIC

Ministry of Migration & Asylum

- Në rastin kur Komisioni i Apelit vendos t'ju ftojë në intervistë, do të informoheni jo më vonë se dhjetë (10) ditë pune përpara datës së intervistës. Keni të drejtë të shkoni pranë Komisionit të Apelit me avokat ose këshilltar tjetër.
- Komisioni i Apelit do të vendosë nëse do t'ju japë statusin e refugjatit ose përfituesit të mbrojtjes plotësuese (subsidiare), ose do të refuzojë apelimin tuaj.
- Për dhënien në dorëzim të vendimit të Komisionit të Apelit procedura është e njëjtë me atë të dhënies në dorëzim të vendimit të Shërbimit të Azilit.
- Vendimi i apelimit mund të dalë në periudhën kohore nga pesëmbëdhjetë (15) ditë deri në tre (3) muaj, në varësi me rastin.
- Nëse apelimi juaj refuzohet ose ju jepet statusi i mbrojtjes plotësuese (subsidiare), ndërkohë që ju pretendoni se meritoni statusin e refugjatit, mund të parashtroni kërkesë anulimi pranë Gjykatës Administrative kompetente vendore të Shkallës së Parë brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e parë pas dorëzimit të vendimit. Kërkesa për anulim nuk ka efekt pezullues të menjëhershëm, domëthenë është i mundshëm largimi juaj nga vendi, në rastin kur apelimi juaj është refuzuar.

Mbajtja në arrest e kërkesve të mbrojtjes ndërkombëtare

- Nëse jeni në arrest ose qëndroni në Qendër Pritjeje dhe Identifikimi (QPI), Organet e mbajtjes në arrest ose të pritjes dhe identifikimit do të informojnë Shërbimin e Azilit për dëshirën tuaj që të depozitoni kërkesë mbrojtjeje ndërkombëtare, dhe do të programohet regjistrimi i kërkesës suaj.
- Ditën e regjistrimit ose do të bëhet transferimi juaj në Zyrrat Rajonale të Azilit që ndodhen më pranë, ose do të regjistroheni në Njësinë e Shërbimit të Azilit që funksionon në vendin ku ndodheni.
- Regjistrimi do të zhvillohet me ndihmën e përkthyesit, në gjuhë që kuptoni, ndërsa personeli i Shërbimit do t'ju paraqesë të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me procedurën
- Nëse keni dokumenta që vërtetojnë identitetin tuaj, si pasaportë, ose dokumenta të tjera që kanë lidhje me kërkesën tuaj do të duhet t'i keni me vete. Gjatë depozitimit të kërkesës suaj do të fotografoheni dhe do t'u merren shenjat e gishtërinjve.
- Pas regjistrimit në vënd të kartës së kërkesit të mbrojtjes ndërkombëtare, do t'ju jepet një dokument në të cilin përmendet data në të cilën do të duhet të paraqiteni në intervistë.
- Nëse depozitoni kërkesë mbrojtjeje ndërkombëtare ndërsa mbaheni në arrest sepse keni kryer vepër penale, do të vazhdoni të mbaheni në arrest deri sa të kryeni dënimin që ju është dhënë.
- Nëse depozitoni kërkesë mbrojtjeje ndërkombëtare ndërsa mbaheni në arrest sepse u futët në mënyrë të paligjshme në vend ose sepse është në procedim largimi juaj nga vendi, ka mundësi që, nëse Policia gjykon se nuk mund të zbatohen për rastin tuaj masa të tjera, të vazhdoni të mbaheni në arrest:
 - a) që të verifikohen të dhënat aktuale të identitetit ose të prejardhjes suaj
 - b) të përcaktohen ato të dhëna në të cilat mbështetet kërkesa juaj, disponimi i të cilave do të ishte në rast të kundërt i pamundur, sidomos kur ekziston rreziku i arratisjes.



c) kur ekzistojnë arsye të bazuara që të konsiderohet se depozituar kërkesën me qëllim vonimin ose pengimin e zbatimit të vendimit të kthimit

d) përderisa përbëni rrezik për sigurinë kombëtare ose rendin publik

e) kur ekziston rrezik serioz arratisjeje në bazë të përkufizimit të Rregullores (BE-së) neni 604/2013, dhe në mënyrë që të garantohet kryerja e procedurës së transferimit në bazë të Rregullores së mësipërme.

- Mbajtja juaj në arrest mund të zgjasë nga pesëdhjetë (50) ditë deri më tetëmbëdhjetë (18) muaj në varësi të arsyes së mbajtjes në arrest. Për mbajtjen tuaj në arrest vendos Drejtori i Policisë i cili, në vendimin e tij, do të duhet të shpjegojë me hollësi përse u vendos mbajtja juaj në arrest.

- Kundër vendimit të mbajtjes në arrest keni të drejtë të paraqesni kundërshtime kundrejt Kryetarit ose Gjykatësit kompetent të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë në qarkun e së cilës mbaheni në arrest.

- Nëse vendosni të jepni dorëheqjen nga kërkesa juaj do të duhet që ta deklaroni personalisht përpara nëpunësit kompetent të Shërbimit të Azilit. Nëse nuk funksionon Njësi e Pavarur Azili brenda ose pranë vendit ku mbaheni në arrest, do të duhet të bëhet transferimi juaj pranë Zyrës së Azilit Rajonale më të afërt për këtë arsye.

- Nëse jeni i mbajtur në arrest ose qëndroni në ambientet e Shërbimit të Pritjes dhe të Identifikimit, karta e kërkuarit të mbrojtjes ndërkombëtare duhet t'ju jepet ditën që do të liheni i lirë ose pasi të mbarojnë procedurat e Pritjes dhe Identifikimit, përderisa procedohet akoma shqyrtimi i kërkesës suaj. Do të duhet patjetër të paraqiteni menjëherë pranë Zyrës Rajonale kompetente të Azilit për të deklaruar të dhënat tuaja të komunikimit dhe t'ju jepet karta në rast se nuk ju është dhënë akoma.

- Dhënia e vendimit që i përket kërkesës suaj bëhet personalisht nga nëpunësi kompetent i Shërbimit të Azilit ose nga Përgjegjësi i Autoritetit të Mbajtjes në Arrest, i Qendrës ose i Qendrës së Strehimit

- Nëse vendimi është refuzues, mund të ushtroni apelim personalisht përpara nëpunësit kompetent të Shërbimit të Azilit.

- Nëse nuk funksionon Njësi e Pavarur Azili brenda ose pranë vendit ku mbaheni në arrest, do të duhet të bëhet transferimi juaj pranë Zyrës Rajonale të Azilit më të afërt.

- Në rast se qëndroni në Qëndër Strehimi ose larg Zyrës Rajonale të Azilit që nxorri vendimin, mund të depozitoni apelim pranë Zyrës Rajonale të Azilit më të afërt ose pranë Përgjegjësit të Qendrës.

- Nëse vendimi është pozitiv, do të dalë vendim anulimi i mbajtjes suaj në arrest. Ditën që do të liheni i lirë do t'ju jepen dokumentet e nevojshme. Do të duhet patjetër të paraqiteni menjëherë pranë Zyrës Rajonale të Azilit kompetente që të deklaroni adresën dhe të dhënat tuaja të komunikimit.

Kërkesë e Mëvonshme

Kërkesë e mëvonshme është kërkesa e mbrojtjes ndërkombëtare që depozitohet sërish pas përgjigjes refuzuese të formës së prerë nga Policia, ose Shërbimi i Azilit, ose Autoriteti i



HELLENIC REPUBLIC

Ministry of Migration & Asylum

Apelit, ose pas dorëheqjes suaj nga kërkesa e mëparshme për mbrojtje ndërkombëtare. Që të depozitoni kërkesë të mëvonshme pranë Shërbimit të Azilit do të duhet të keni marrë nga Policia Greke ose nga Shërbimi i Azilit vendim refuzues të formës së prerë dhe të keni arsye të reja për të cilat kërkonti t'ju jepet mbrojtje ndërkombëtare (azil)

Do të duhet të depozitoni kërkesën e mëvonshme në Zyrën Rajonale të Azilit ose në Njësinë e Pavarur të Azilit që ndodhet më pranë vendbanimit tuaj dhe të depozitoni të dhënat e reja që dolën në pah. Pas depozitimit të kërkesës së mëvonshme nuk do t'ju jepet kartë kërkuesi i mbrojtjes ndërkombëtare.

Shërbimi i Azilit do të shqyrtojë të dhënat e reja që do depozitoni dhe do të vendosë nëse janë të rëndësishme për kërkesën e mbrojtjes ndërkombëtare. Vetëm nëse pranohet kërkesa juaj e mëvonshme do t'ju jepet kartë kërkuesi i mbrojtjes ndërkombëtare dhe do të vazhdojë shqyrtimi i kërkesës suaj nga Shërbimi i Azilit

Nëse Shërbimi refuzon kërkesën tuaj të mëvonshme mund të ushtroni apelim kundrejt Autoritetit të Apelit brenda afatit që përmendet në vendimin që ju është dorëzuar.

Nëse depozitoni kërkesë të dytë të mëvonshme, gjatë stadi të shqyrtimit nuk mbroheni nga dëbimi/kthimi.

Do të dëshironim t'ju informojmë se, ndalohet të hyjnë në ambientet e Shërbimit të Azilit: armë, sende me majë ose sende të tjera që mund të përdoren për të shkaktuar plagosje, lënde shpërthyese dhe djegëse, përbërje kimike dhe toksike.

Gjithashtu, do të ndalohet hyrja e personave që mbajnë bagazhe ose çanta, me përjashtim të dosjeve dhe të çantave të vogla të dorës.

Përdorimi i celularëve do të kufizohet vetëm në ambientet e jashtme të Shërbimit të Azilit, ndërkohë që ndalohet të bëni fotografi apo video brenda dhe jashtë ambienteve të Shërbimit të Azilit.